



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
MINISTRI**

**PROJEKT - UDHËZIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT TË  
TRAFIKUT TË KOMUNIKIMEVE SI DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË  
PËRDORUESVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 4 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofrojnë aksesin në Internet, të garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të menaxhimit të trafikut në ofrimin e shërbimit të aksesit në Internet, si dhe të drejtat e përdoruesve fundorë.
2. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur prej tyre mbi matjen dhe drejtimin e trafikut me qëllim shmangien e ngarkesës ose mbingarkesës së lidhjeve të rrjetit, si dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit.
3. Përdoruesit fundor kanë të drejtë të marrin akses në informacionet dhe përmbajtjen e ofruar në Internet (si video, muzikë, foto etj.) dhe t’i shpërndajnë ato, si dhe të përdorin dhe/ose ofrojnë aplikacione dhe shërbime, të përdorin pajisje fundore sipas zgjedhjes së tyre, pavarësisht nga vendndodhja e përdoruesit apo e ofruesit të shërbimeve ose pavarësisht nga vendndodhja, origjina ose destinacioni i informacioneve, përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve, nëpërmjet shërbimit të aksesit në internet. Kjo e drejtë nuk anashkalon apo ndikon në detyrimet që burojnë nga legjislacioni i posaçëm në lidhje me ligjshmërinë e përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve të komunikimit elektronik.

---

<sup>1</sup> Ky udhëzim përfaqëson pjesërisht Rregulloren (BE) 2015/2120 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 nëntor 2015 që përcakton masat në lidhje me një akses të lirë të Internetit dhe që modifikon Direktivën 2002/22/KE të shërbimit universal dhe të drejtave të përdoruesve në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik dhe rregulloren (BE) nr. 531/2012 në lidhje me shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve mobile brenda Bashkimit Evropian

4. Kontratat e pajtimit, midis ofruesve të shërbimeve të aksesit në Internet dhe përdoruesit fundor mbi kushtet dhe karakteristikat tregtare e teknike të shërbimit të aksesit në Internet, si për tarifën, volumin e të dhënave ose për shpejtësinë e lidhjes, si dhe praktikën tregtare të aplikuar nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet nuk e kufizojnë ushtrimin e të drejtave të përdoruesve fundorë sipas kërkesave të parashikuara në pikën 3 të këtij Udhëzimi.
5. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet, gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve, trajtojnë të gjithë trafikun e komunikimit të të dhënave në të njëjtën mënyrë, pa diskriminime, kufizime ose ndërhyrje, pavarësisht nga burimi dhe destinacioni i përmbajtjes, nga aplikacionet ose shërbimet e përdorura ose të ofruara apo nga pajisjet fundore të përdorura.
6. Kërkesat e parashikuara në Pikën 5 të këtij Udhëzimi nuk parandalon ofruesin e shërbimeve të aksesit në Internet të zbatojë masa të arsyeshme për menaxhimin e trafikut. *AKEP me anë të një rregulloreje mund të specifikojë / detajojë rastet e menaxhimit të arsyeshëm të trafikut, si dhe kërkesat për cilësinë e shërbimit në lidhje me menaxhimin e trafikut.*
7. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve, ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet marrin masa që kontratat që përfshijnë shërbime të aksesit në Internet të saktësojnë minimalisht informacionin mbi impaktin e mundshëm që mund të kenë masat për menaxhimin e trafikut, të aplikuar nga ofruesi mbi cilësinë e shërbimeve të aksesit në Internet, mbi jetën private të përdoruesve fundor dhe mbi mbrojtjen e të dhënave të tyre personale. Të japin shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave që mund të vijnë si rezultat i kufizimeve të volumit, shpejtësisë dhe të parametrave të tjerë të cilësisë së shërbimit, për shërbimet e aksesit në Internet dhe në veçanti mbi përdorimin e përmbajtjeve, aplikacioneve dhe shërbimeve, një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave në rastet e optimizimit të trafikut dhe shpejtësisë së aksesit. Kontrata e pajtimtarit përmban informacion mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast të shkeljeve të përsëritura apo mospërbushjes së cilësisë së shërbimit të kontraktuar.
8. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet të parashikojnë procedura transparente, të thjeshta dhe eficientë për të trajtuar ankesat e përdoruesve fundor, publikohen në faqen e tyre të internetit dhe vihen në dispozicion në pikat e shitjes.
9. AKEP mbikëqyr praktikën për menaxhimin e trafikut të aksesit në internet nga ofruesit e shërbimit dhe parashikon kërkesa mbi karakteristikat teknike, kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe masa të tjera të përshtatshme dhe të nevojshme për një ose më shumë ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, përfshirë këtu edhe ofruesit e shërbimeve të aksesit në Internet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet për zbatimin e tij fillojnë nga data 1 janar 2020.

**MINISTRI**

**Belinda BALLUKU**